

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA KOMUNALE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtari Ilir Bytyqi si dhe sekretaren juridike Vildane Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit, K.M. nga Fsh. .... K. Ferizaj, për shkak të veprës penale mospërfillje e gjykatës nga neni 401 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP.nr.61-3/15 të dt. 22.04.2015, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur me dt. 07.09.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Visar Musa dhe të pandehurit K.M., të njejtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë :

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri: **K.M.** data e lindjes....., nga i ati S. dhe nëna Z. e gjinisë G., me vendbanim në Fsh. .... K. Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e fillore, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri.

**Konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.1 të KPPK-së,**

**LIROHET NGA AKUZA**

Se me datën 16.01.2015, rreth orës 15:00, në Fsh. .... K. Ferizaj, i pandehuri me qëllim nuk iu ka bindur urdhërit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Aktvendimit PPRKR.nr.61/14 dt. 01.12.2014, në lëndën nga Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr. 1229/14 dt. 24.11.2014, nga i cili është caktuar masa e arrestit shtëpiak nga 01.12.2014 deri më 31.01.2015, dhe me rastin e kontrollit nga patrulla policore nuk e kanë gjetur në shtëpinë e tij, duke mos respektuar masën e gjykatës.

**me çka do të të kryente veprën penale mospërfillje e gjykatës nga neni 401 par. 1 të KPRK-së.**

**Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.**

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Ferizaj ka sjellë për gjykim çështjen penale sipas aktauzes PP.nr.61-5/14 dt. 22.04.2015, në ngarkim të pandehurin K.M. nga K. Ferizaj të akuzuar për veprën penale të mosperfilljes e gjykates nga neni 401 par. 1 të KPRK-së, dhe ne shqyrtimin gjyqësor deri ne fjalen perfundimtare ka propozuar qe te i shqiptoj nje sanksion penal te parapar me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështjaeshte ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet perparakesaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe teritoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 07.09.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuara K.M. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë sipas aktakuzes.

Gjyqtari Individual, konform nenit 248 par. 3 me Aktvendim i refuzon pranimin e fajsisë te pandehurit pasi nuk bindet se jane vertetuar faktet e qështjes qe përmban akuza.

Pasi që të akuzuari nuk ju është pranuar fajsia per veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bere paqaqitjen e provave dhe pas vlersimit te tyre nje nga nje dhe duke i ndërlidhur reciprocikisht njërën me tjetern, ne kuptim te nenit 361 par. 1 dhe 2 te KPPK-së, vërtetoj gjendjen e fakteve te përshkruar hollësisht ne dispozitivin e këtij aktgjykimit:

**Rrethanat e faktit te çeshtjes lidhur me kete procedim kane rezultuar si me poshte:** me dt. 16.01.2015, rreth orës 14:00, ne Fsh. Koshare, teke Reastauranti “.....”, kishte ndodhur nje rrahje/sulm fizik, mes disa pesonave, pas verifikimit te keture personave del te jete i involvuar si i demtuar K.M. i cili ishte ne masen e arrestit shtepiak sipas aktvendimit te dt. 01.12.2014, ne lidhje me kete rast nje patrull nga stacioni policor ne Ferizaj eshte shkuar ne shtepi e K.M., mirpo ky i fundit nuk ka qene ne shtëpi.

I pandehuri K.M., ne mbrojtjen e tij ne lidhje me kete procedim penal ka deklaruar ne shqyrtimin gjyqësor se: e di që në vitin 2015, kam qenë ne masen e arrestit shtëpiak, po ashtu edhe policia e St. Ferizaj ka qenë tekë shtëpia ime per te vertetuar se a jam duke respektuar masen e arrestit shtepiak, atë moment une kam qenë në shtëpia, e kam ditur qe duhet te respektohet kjo mas e vën nga gjykata, ditën kritike kam dalur pasi kami patur me u pajtu me disa persona qe kemi patur nje telashe, sapo jamë takuar me keta persona njëri nga ata me ka goditur ne kokë, mua më kanë transportua ne emergjenc, pastaj me ka marrë policia me kan sjell ne gjykat para gjyqtarit dhe nga ai moment me eshte zëvendësuar masa e arrestit shtepiak ne masen e paraburgimit per te cilen ne tersi kam mbajtur paraburgimin.

Me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor publik dhe vlerësimin e tyre veç e veç dhe në lidhje me prova tjera konform nen. 387 par. 2 të KPPK-së Gjykata gjeti se nuk u provua se i pandehuri K.M. të ketë kryer veprën penale mosperfillje e gjykatës nga neni 401 par. 1 të KPRK-së.

Materialet të cilat gjinden në shkresat e lëndës vertetohet se ditën kritike pa dyshim i pandehuri ka shkel masen e arrestit shtëpiak te vendosur nga gjykata themelore ne Ferizaj PPRKR.nr.61/14 të dates 01.12.2014, mirpo te pandehurit per kete shkelje i eshte zevendesuar masa e arrestit shtepiak ne masen e paraburgimit me aktvendim PPRKR.nr.61/14 të dt. 17.01.2015, pasi qe ne kete aktvendim i pandehuri ka qene i detyruar te qendroj ne shtepin e tij ne Fsh. .... K. Ferizaj, dhe i njejt i nuk ka guxuar te largohet nga shptepia e tij pa leje e gjykates i njejt i ka qene i paralajmeruar me anë të aktvendimit se nese pa leje adekuate nuk i permbahet kerij vendimi, ndaj te njejt i do te caktohet masa e paraburgimit për ç'ka gjykata edhe ka vepruar konform dispozitave ligjore.

**Sa më sipër**, nuk është provua fajësia në gjykimin e çështjes me provat e paraqitura nga organi i akuzës respektivisht nga i akuzuari K.M. dhe të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, ndër të cilat theksohen:

- Aktvendimi PPRKR.nr.61/14 i dt:05.11.2014, caktimi i paraburgimit,
- Aktvendimi PPRKR.nr.61/14 i dt:01.12.2014, caktimi i masës së arrestit shtëpiak,
- Aktvendimi PPRKR.nr.61/14 i dt:17.01.2015, zëvendësimi i masës së arrestit shtëpiak në masën e paraburgimit.
- Aktvendimi PN.1.nr.111/15 i dt:23.01.2015, Gjykata e Apelit refuzim i ankesës.

Kjo Gjykatë çmon se provat e paraqitura nga organi i akuzës, duhet t'i nënshtrohet, në kuptim të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, shqyrtimit gjyqësor, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar. Në një proces penal organi i prokurorisë ka barrën e provës dhe detyrimin ligjor për të provuar akuzën, ndërsa i pandehuri gëzon garancinë kushtetuese të prezumimit të pafajësisë.

Nga vlerësimet e dëshmisë së të pandehurit K.M. dhe shkresave materiale të cilat gjenden në lëndë, nuk mund të konstituohen elementet objektive dhe subjektive të veprës penale në barret e të pandehurit.

Në rastin objekt gjykimi, gjykata vëren se nuk plotësohet standarti i të provuarit në një proces penal, standard ky, i cili imponohet pikërisht nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Gjykata, duke i çmuar provat, të paraqitura nga i pandehuri K.M. e të administruara në gjykim, në unitet me njëra tjetrën, bazuar në nenin 361 të KPPR, i cili përcakton mënyrën e çmuarjes së provave, vlerësimin e fuqisë provuese dhe vërtetësisë së tyre në bazë të përmbajtjes së secilës dhe bindjes së brendshme të gjykatës, arrin në konkluzionin se ndryshe nga ç'pretendohet nga akuzat, veprën për të cilën akuzohet I akuzuari nuk përben veprës penale.

**Duke u bazuar në vlerësimin e mësipërm të provave të paraqitura nga organi i akuzës në raport me përmbajtjen e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, analiza e elementëve të figurës së kësaj vepre penale paraqitet si më poshtë:**

v.p. nga neni 401, mosperfillje e gjykatës: kushdo qe nuk I bindet ndonje urdheri, vendimi apo aktgjykimi te pletofuqishem te ndonje gjykate ne R. Kosoves ose refuzon apo pengon publikimin e vendimit apo aktgjykimin te plotfuqishem te gjykates se till, denohet me.....

- *Objekti i vepres penale; veprimet e kryera nga i pandehuri, duhet te cenojne urdherin, aktvendimin apo aktgjykimi te plotfuqishem te ndonje Gjykare ne R. Kosoves.*
- *Nga ana objektive, vepra penale e konsumuar nga e pandehura, duhet te kryer me veprime aktive, si dhe duhet te egzistoj pasoja juridike.*
- *Nga ana subjektive, gjykata, duhet te arrin ne perfundimin se veprimet e kryera nga e pandehura, jane kryer prej tij ne formen e dashjes direkte apo indirekte.*
- *Subjekti, Gjithashtu, gjykata, konstaton se moshja madhore, si dhe pergjegjshmeria e plote e te pandehurit, e ben ate te jete perpara kriterëve ligjore per te mbajtur pergjegjesi penale.*

Per gjykaten nuk eshte formuar plotesisht figura e elementeve objektive dhe subjektive te vepres penale mospergillja e gjykates nga neni 401 par. 1 te KPRK-së, nuk eshte kontestuese se i pandeuri ka shkelur masen e arrestit shtepiak, nuk eshte kontestuese se ST. Policor ne Ferizaj ka shkuar ne shtepin e te pandehurit per verifikim nese i pandehuri eshte duke respektuar vendimin e Gjykates PPRKR.nr.61/14 dt. 01.12.2014, per te cilen policia ka sjell memorandumin zyrtar mbi shkeljen e mases se arrestit shtepiak, dhe se ne baze te te gjeturave eshte mbajtur seanca degjimore mbi shkeljen e mases se arrestit shtepiak, ku gjyqtari i pracedures paraprake merre Aktvendim PPRKR.nr.61/14 dt. 17.01.2015, ka zëvendësuar masen e arrestit shtepiak ne masen e paraburgimit, pas te ciles mbrojtasi i te pandehurit K.M. av. R.Sh. ka paraqitur ankese ndaj ketij aktvendimi per te cilen Gjykata e Apelit ka refuzuar si te pa bazuar ankesen ne fjal.

Prandaj, sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret ka për oblogim ligjor që të provoj në mënyrë të pa kontestueshme të gjitha faktet të cilat janë në favor dhe disfavor për të akuzuarin, duke i nderlidhur edhe me prezunimin e pafajësisë dhe me parimin ”in dubio pro reo” mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për qeshtjen duhet të interpretohen në favor të të akuzuarit bazuar në këtë gjykatë nuk gjeti ndonjë provë materiale që deshmohet fajësia e të pandehurit, andaj në bazë të kësaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.1 të KPPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.502/15 të dt. 07.09.2016**

Sekretarja Juridike  
Vildane Azemi

**Gjyqtari Individual,**  
**Ilir BYTYQI**

**KËSHILLA JURIDIKE** – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.